



[Signature] 86-06-2018

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me Bashk.Profesionale Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED], i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.449-10/18 e datës 28.03.2018, sipas së cilës e ka kryer veprën penale” rrezikimi i trafikut publik” nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.27.04.2018 solli:

AKT GJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.449-10/18 të dt. 23.03.2018, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED], i lindur me datë, [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], doganier-Glloboqice, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, vërtetuar ne baze te letërnjoftimit te tij me nr.personal [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt.28.01.2018, rreth orës 20:00, ne rrugën magjistrale ne fsh:Rakaj, Komuna e Ferizaj, i pandehuri ka qene duke drejtuar automjetin zyrtar te Doganës te markës “Toyota Runner”, me targa [REDACTED] me ngjyre te bardhe, ne kundërshtim me nenin 41.1 te LSKRR-se, nga pakujdesia me te kaluar pompën e benzinës “Ballkan Petrol” ka ndërmarr veprimin e tejkalimit pa u bindur mire se me veprimin e tille do te rrezikoj veten dhe pjesëmarrësit e tjerë ne komunikacion ashtu qe me pjesën e përparme te anës se djathte e godet ne te dy dyert e anës se majte automjetin “Mercedes 320 ML” me targa te regjistrimit [REDACTED], me ngjyre te zeze, te cilën e drejtonte [REDACTED] meqë rast pos dëmeve materiale ne automjete, lëndime te lehta trupore ka pësuar bashkudhëtari i te pandehurit [REDACTED] dhe ate; ndrydhe te indeve te buta te kokës, përdredhje te indeve te buta te qafës, regjionit deltoid te krahut te dorës dhe regjionit te kofshës se këmbës se majte, me pasoja te përkohshme per shëndetin, te përshkruara sipas ekspertizës mjeko ligjore te datës 10.03.2018,

- me të cilën kreu veprën penale "rrezikimi i trafikut publik" nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Gjykata të dëmtuarin: [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale 60.88€, paushalli gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € dhe 30 euro taksen për kompensimin e viktimave të kriminit, të gjitha në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.449-10/18 të dt. 28.03.2018, ka akuzuar [REDAKTUAR] nga Ferizaj, Rr. [REDAKTUAR], për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënie të urdhrit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjegjësisht konstatimin e ekspertit mjeko ligjor i dt. 10.03.2018, mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 07.03.2018, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga fsh [REDAKTUAR] K.Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së, lidhur me nenin 453 par.1 te KPPK-se, dhe neni 39 par.1 nen par.3,1 te ligjit per kompenzimin e viktimave te krimit nr.05/L-036.


Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr 470/18 i datës 27.04.2018

Bashk.Profesionale
Mimoza Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.